

Nga: Fondacioni Kosovar për Shoqëri Civile (KCSF) dhe [] organizata jo-qeveritare

THIRRJE PËR VOTIM TË KËRKESAVE TË SHOQËRISË CIVILE NË LEXIMIN E TRETË TË LIGJIT PËR LIRI TË ASOCIMIT NË OJQ

Shoqëria civile është shtyllë e një shoqërie demokratike, dhe Kosova aspiron për t'u bërë shtet demokratik, i qytetarëve të barabartë dhe i përfshirë në familjen e shteteve Euro-Atlantike. Organizatat jo-qeveritare janë pjesa kryesore e shoqërisë civile, ndërsa parimi jo-për-përfitim është themeli i këtij sektori. Ligji për liri të asociimit në OJQ i miratuar më 7 nëntor 2018 nga Kuvendi i Kosovës e shkel këtë parim, dhe me këtë e shkatërron themelin e këtij sektori. Ky ligj e legalizon mundësinë që pasuria e OJQ-ve të tjetërsohet dhe t'i kalojë edhe institucioneve private, mundësi kjo e paprecedent në Europë dhe më gjerë.

Miratimi në lexim të dytë më 7 nëntor 2018 erdhi pas amandamenteve të momentit të fundit të propozuara nga Komisioni për Administratë Publike, e të cilat e ndryshuan përmbajtjen e shumë dispozitave bazike të këtij ligji. Prezantimi nga Kryetari i Komisionit u karakterizua me informata të pavërteta mbi sektorin e shoqërisë civile dhe manipulim të përmbajtjes së amandamenteve të propozuara.¹ Ngjashëm ndodhi edhe në takimin e këtij komisioni më 12 dhjetor 2018, pas kthimit të ligjit nga Presidenti, i cili u karakterizua me deklarata fyese dhe kërcënuese ndaj shoqërisë civile nga disa deputetë dhe me prezantim të pjesshëm dhe manipulues të kërkesave të shoqërisë civile. Për ilustrim, Kryetari i Komisionit gjatë seancës së 7 nëntorit, sikurse edhe në takimin e Komisionit të 12 dhjetorit, shpreh brengën për kapitalin prej mbi 200 milionë eurosh të OJQ-ve mikrofinanciare, përderisa Amandamenti 31 për Nenin 41 paragrafi 2 në të vërtetë u'a mundëson këtyre OJQ-ve që këtë kapital ta transferojnë në biznese private. Me këtë dispozitë të ndryshuar, fondet të cilat janë dhënë për sektorin jo-qeveritar nga donatorët e huaj, buxheti i Kosovës, donatorët privat apo qytetarët e Kosovës për çështje të interesit publik lejohet që t'a ndryshojnë destinimin e tyre dhe të kalojnë në xhepa të individëve pronarë të bizneseve private.

Përderisa votimi në seancën e 7 nëntorit mund të ketë ardhur si pasojë e keqinformimit, tashmë të gjitha grupet parlamentare dhe secili deputet janë të njoftuar detajisht me përmbajtjen e dispozitave të këtij ligji dhe pasojat e mospërmirësimit të tyre, sidomos Nenit 41 paragrafi 2. Pavarësisht përkatësisë partiake, qëndrimeve politike ditore apo interpretimit të procedurave, është detyrë e secilit deputet të sigurohet që keqpërdorime të tilla të parandalohen, e aq më tepër të mos bëhen të ligjshme nëpërmjet votës së tyre. Për t'a bërë këtë, tashmë kërkohet vota e të paktën 61 deputetëve të Kuvendit të Kosovës gjatë leximit të tretë, në përkrahje të kërkesave të qindra organizatave të shoqërisë civile, të përfshira në amandamentet e Presidentit.

Duke i përkrahur kërkesat e shoqërisë civile për të kthyer ligjin në verzionin para amandamenteve kufizuese, vota e tyre mbron parimet ndërkombëtare,² lirinë e asociimit,³ të drejtën e pronës,⁴ Aktgjykimin e Gjykatës Kushtetuese në rastin KO 97/12 për Ligjin për Bankat,⁵ si dhe vlerat e BE-së të zyrtarizuara edhe nëpërmjet MSA-së.⁶ Për të evituar të gjitha dilemat, partitë politike dhe deputetët individual duhet të pozicionohen qartë dhe publikisht në raport me kërkesat e shoqërisë civile dhe votën e tyre në leximin e tretë. Në të kundërtën, do të mbajnë përgjegjësi për legalizimin e një praktike korruptive që inkurajon keqpërdorimin e qindra miliona eurove tani dhe në të ardhmen dhe i'a shemb themelet shoqërisë civile dhe zhvillimit demokratik të vendit në përgjithësi.

¹ Transkripti i mbledhjes plenare të Kuvendit të Republikës së Kosovës të mbajtur më 2, 7 dhe 23 nëntor 2018

² Udhëzuesi i Komisionit të Venedikut për lirinë e asociimit i vitit 2014

³ Neni 44 i Kushtetutës së Republikës së Kosovës

⁴ Neni 46 i Kushtetutës së Republikës së Kosovës

⁵ Pika 138 e Aktgjykimit në rastin KO 97/12 në Gjykatën Kushtetuese mbi vlerësimin e kushtetutshmërisë së neneve të ndërlidhura me subjektivitetin juridik të OJQ-ve në Ligjin 04/L-093 për banka, institucioneve mikrofinanciare dhe institucione financiare jobankare

⁶ Marrëveshja e Stabilizimit Asociimit në mes të BE-së dhe Kosovës, Preambula (pika 4) dhe Parimet e përgjithshme (Neni 3)

Organizatrat përkrahëse (sipas renditjes alfabetike):

1. Demokracia për Zhvillim (D4D)
2. Fondacioni Kosovar për Shoqëri Civile (KCSF)
3. Grupi për Studime Politike dhe Juridike (GLPS)
4. Iniciativa Kosovare për Stabilitet (IKS)
5. Instituti i Kosovës për Drejtësi (IKD)
6. Instituti Kosovar për Hulumtim dhe Zhvillim të Politikave (KIPRED)
7. Instituti për Studime të Avancuara GAP
8. Organizata për Demokraci, Anti-korrupsion dhe Dinjitet, Çohu!
9. ...
10. ...
11. ...
12. ...